

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8952, DATË 10.10.2002, “PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHITESASVE SHQIPTARË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në nenin 4, të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, është parashikuar afati 10-vjeçar i vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike.

Lëshimi i letërnjoftimeve elektronike ka filluar në datën 9.2.2009 dhe përfundon, sipas datës së lëshimit, përgjatë vitit 2019. Pavarësisht njoftimeve të shumta, aplikimi për rinovimin e kartave ka sjellë fluks aplikimesh nga shtetasit shqiptarë pranë zyrave në të gjitha bashkitë. Duke qenë se letërnjoftimi elektronik shërben si dokument identiteti bazë për identifikimin e shtetasve shqiptarë, i cili u jep mundësinë për të votuar, u siguron marrjen e shërbimeve të ndryshme publike (por jo vetëm), si dhe shërben si “dokument udhëtimi” (ndër dokumentet e tjera të vlefshme të udhëtimit) drejt shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dypalëshe për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, për të mundësuar që të gjithë shtetasve shqiptarë, të cilëve u përfundon afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronike, t’u sigurohet e drejta kushtetuese e votës si dhe marrja e një numri të madh shërbimesh që kushtëzohen nga ky dokument zyrtar, me anë të këtij ndryshimi propozohet që afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve, që janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2019.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i propozuar nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për vitin 2019, por është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet në projektligj vijnë si domosdoshmëri për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve, të cilëve u skadon afati i vlefshmërisë së kartës ID përgjatë vitit 2019.

Duke qenë në dijeni të faktit se afati 10-vjeçar i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik, sipas të dhënave statistikore të marra nga shoqëria koncesionare “ALEAT”, sh.p.k., të pothuajse 1.4 milionë shtetasve shqiptarë, përfundon në vitin 2019, dhe afati kohor në dispozicion për ripajisjen me letërnjoftim të ri elektronik është mjaft i kufizuar, është vlerësuar që të zgjatet afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik për të gjitha ato letërnjoftime elektronike, të cilave u përfundon afati gjatë vitit 2019.

Skadimi i afatit të ID-së ndodh në shumë raste edhe me skadimin e afatit të pasaportës biometrike dhe, bazuar në nenin 105, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, “Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit”, shtetasi duhet të paraqitet të votojë me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike. Kjo sjell domosdoshmërinë e zgjatjes së këtij afati.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1, të saj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga dy nene.

Në nenin 1, të tij, është propozuar të shtohet neni 9/1, si dispozitë kalimtare, në bazë të të cilit propozohet zgjatja e afatit të vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike të shtetasve shqiptarë, të cilat janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, deri në datën 31.12.2019.

Në nenin 2, të këtij projektligji, parashikohet hyrja në fuqi e tij 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, kompania koncesionare “Aleat”, sh.p.k., dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

VIII.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shitesë për buxhetin e shtetit, pasi ka karakter teknik.

KËSHILLI I MINISTRAVE